



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 42-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.05.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
21. Ganimete Qeriqi, anëtare
22. Alban Salihu, anëtar
23. Fitim Meziu, anëtar
24. Fadil Spahiu, anëtar
25. Fatmir Fetahu, anëtar
26. Shahadije Dragaçina, anëtare
27. Besiana Sylja, anëtare
28. Enver Kryeziu, anëtar
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës.
3. Latif Ramadani, DBF
4. Elmaze Behluli, DA
5. Sead Aliu, DI
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DKA
9. Safete Amerllahu, DGJK
10. Flamur Sylejmani, DI
11. Burim Rrustemi, DSHPMSH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica- Llugiqi, DKRS
14. Shkelzen Hajdini, DSHP
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 41-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit (2025-2030) dhe Planit të Veprimit Rinor Lokal (2025-2027).
3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë Muze të veteranëve të UÇK-së në Zonën Kadastrale Krojmir.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.
5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ZK-Grackë e Vjetër.
6. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Kryetarëve të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide-zyra në Kosovë (IRW).

Pastaj kryesuesi tha se me propozim të ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së. Kemi edhe një pikë shtesë:

8. Propozim Vendim për furnizimin e përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative "KRM" Pastrimi në Lipjan.

Po ashtu keni edhe një pikë tjetër shtesë të cilën e keni pranuar materialin dhe në email

8. Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 1Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës të tokës bujqësore.

Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës:

Ganimete Qeriqi, tha se kam një kërkesë nga ana juaj që para se të votohet rendi i ditës pika e 3-të të hiqet nga rendi i ditës, në këtë rast po flas jashtë petkut të partisë po si veterane e UÇK-së. Si anëtare e kuvendit kam autorizim nga lagjja Qeriqi gjegjësisht lagjja Shemaj që të kërkoj që pika e tretë të hiqet nga rendi i ditës 3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë Muze të veteranëve të UÇK-së në Zonën Kadastrale Krojmir. Ne si lagje e kundërshtojmë sepse kjo nuk i bën nder askujt. Gjene një lokacion tjetër dhe ne e përkrahim pasi që ka vende tjera në Krojmir që i përshtaten. Arsyeja është që ne si lagje jemi anashkaluar dhe nuk është pyetur askush nga lagjja jonë dhe kjo lagje ka dorzuar një petition që e ka ose Kryetari i Komunës ose juve si kryesues. Lagjja jonë unanimisht e kundërshton një propozim të tillë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit tha se keni të drejt me pas vërejtje të rendi i ditës, për ata edhe kërkonte arsyetimin pse po kërkonte të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë. Kërkesa për ndërtimin e kësaj shtëpie ka ardhë nga fshati Krojmir dhe nga veteranet e UÇK-së, të fshatit Krojmir dhe si kërkesë ka ardhë më herët nuk ka ardh sot. Pasi që kjo pikë është në buxhet. Unë deri me tani nuk kam asnjë petition në adresën time po ashtu e pyeta edhe drejtoreshën e kadastrit e cila do ta mbroj këtë pike as ajo nuk ka një petition.

Ganimete Qeriqi, tha kjo kërkesë ka ardhë nga disa individ jo nga akteret kryesor.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit tha se ata janë njerëz të zgjedhur, prej atyre njerëzve të zgjedhur të shoqatës ka ardhur ajo kërkesë.

Shkelzim Olluri, tha se kërkesa ka ardhë nga kryetari i veteranëve të OVL UÇK në Krojmir janë pyet të gjithë dhe nuk ka pas asnjë kundërshtim, mirëpo këtu nuk po i konvenon vetëm disa individëve dhe me këtë i ngritët vlera nuk i humbet vlera.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se është mirë mos me bo si temë ose kauze se kush e ka mirë. Duhet me gjete një gjuhe të përbashkët për me ndërtuar një objekt që është në shërbim të kujtesës dhe memories historike të luftës së UÇK-së. Nuk është në shërbim të asnjë subjekti politik të ndonjë individi apo të grupeve të caktuara, sepse sot mund të jetë dikush, nesër dikush tjetër. Ky është objekt që do të jetë në shërbim të historisë sonë. Objekti i vjetër apo objekti ku është shtabi është objekt nën mbrojtje nga Ministria e Kulturës dhe ne nuk mundemi me ndërhyrë. Na jemi të gatshëm edhe atë objekt me mirëmbajte. Kërkesa e veteranëve për një Objekt Muze, unë skam mundur me refuzuar e as ju nuk do të refuzoni. Kam menduar që ky objekt do të jetë përgjithmonë dhe ky do të jetë objekt muze ku do të ekspozohen pjese të ndryshme të

se kaluarës dhe luftës së UÇK-së. Unë ju kisha lut mos ta politizoni këtë temë, nëse ka telashe ta zgjedhim se bashku. Ky objekt do të jetë për gjeneratat e reja.

Ganimete Qeriqi, unë nuk po flas si partiake por ne jemi si lagje që ky objekt te kalon me një lokacion tjetër për arsye se aty janë varrezat tona.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se është dashtë ti si anëtare e kuvendit me iniciuar më herët këtë problem.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me pikat e propozuara të hynë në rend të ditës dhe pas votimit u konstatua se me 15 vota për, 7 kundër, 7 abstenime u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se sipas rezultateve te transparametrit 2024 të realizuar nga KDI-ja, e rendisin komunën tonë në krye të tabelës duke e renditur në vendin e parë, me këtë rast e përgëzoj kryetarin për këtë. Fillimisht kam një kërkesë për drejtorinë e shëndetësisë që në momentin e publikimit të orarit të barnatoreve kujdestare të përfshihet edhe rruga e secilës barnatore që është në kujdestari. Një sqarim për gjendjen e Kompanisë Pastrimi është kërkesë e qytetarëve, ku gjatë javëve të fundit janë vërejt probleme të mëdha në pastrimin e mbeturinave në disa zona. Kërkoj një informatë nga ana juaj se ne çfarë faze po kalon kompania dhe a është ndërmarr ndonjë zgjidhje konkrete për një zgjidhje me afatgjatë. Kam një pyetje edhe prej Drejtorinë e Urbanizmit lidhur me pronën që ndodhet afër parkut qëndror konkretisht te vazhdimi i sheshit për të cilën është dhënë në shfrytëzim. Ne cilën fazë ndodhet proceduara ne këtë zonë. A është bërë zgjidhje përfundimtare për këtë pronë.

Arsim Jashari, tha se kam disa pyetje e para kane kaluar 5 muaj nga hapja e nënkalimit dhe ende infrastruktura mbështetëse mbetet e pa përfunduar ky projekt që ka kushtuar miliona euro ende është jo funksional. Çka po ndodh pse nuk është funksional. Ku 80 % e fshatrave kane mbet pa investim për shkak të këtij projekti madhor. Duhet të njoftohen qytetarët pse ky projekt po ka probleme. Pyetja e dytë ka të bëjë me punëtorët që kujdesen për pastrimin e komunës ku qe 3 muaj këta punëtor kane mbet pa pagë nga kompania qe ka fituar tenderin për pastrim dhe higjienë. Kjo është padrejtësi ku është menaxheri i kontratës, a po e ndjek dikush nëse po zbatohet marrëveshja, pse komuna vazhdon ta paguaj një kompani qe nuk i paguan punëtorët. Nëse nuk përmbushen kushtet kontrata duhet të ndërrohet. Duhet të intervenohet urgjentisht për këtë çështje. Pyetja tjetër ka të bëjë për papunësinë dhe punësimet lokale, cilat janë veprimet e juaja për ta ulur papunësinë sidomos te të rinjtë dhe gratë.

A keni bashkëpunim me sektorin privat për praktika punësimi ku sipas të dhënave të fundit në komunën tonë janë regjistruar mbi 9600 të pa punë. Tjetra kërkesë, po hyjmë në vitin e 4 qeverisës dhe për fshatin Banullë po flasim për te njëjtat kërkesa që nga dita e parë. Është premtuar renovimi i shkollës, zgjerimi i trotuarit, zgjerimi i rrugës “Lama” mungesë të kapakëve në pusetave, ndërtimi i një çerdhe, madje as premtimi për vendosjen e policeve të shtirë afër shkollës dhe asnjëra nga këto deri tani nuk janë realizuar.

Ardit Cani, tha se kam disa kërkesa e para për Drejtorinë e Shërbimeve Publike për vendosjen e dy pasqyrave të kyçja nga rruga e Magurës për te rruga e Resinovcit e cila është mjaft e frekuentuar dhe e rrezikshme për aksidente. Tjetra të vendoset në hyrje të fshatit Bance. Tjetra të vendosen policet e shtrirë afër shkollës në Bance dhe Resionvc për shkak të vozitjes së veturave në shpejtësi të madhe.

Lulzim Rustemi, tha se kam dy pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit deri ku ka mbërri plani zhvillimor komunal a ka ndonjë indicje apo përfundimisht është dal dhe nuk po zhvillohet më. Dhe e dyta për rrugën Kojskë - Topliqan e përfolur e futur disa herë në projekt herë në nivelin qendror herë lokal dhe asnjëherë e filluar. Ku është problemi dhe a kemi zhvillime rreth kësaj rruge.

Shahadije Dragaçina, tha se i kam dy pyetje e para, Qeveria e Kosovës vitin e kaluar ka ndare 3.8 milion euro për fondin për eficientë për energji, ku përfitues ishte edhe komuna e Lipjanit për renovimin e shkollës fillore në Janjeve. Dua të dije se si po shkojnë zhvillimet atje. Dhe pyetja e dytë, ka pas problem me ndriçim publik në shume fshatra pasi që komuna është arsyetuar se nuk ka një kontratë për ndriçim publik. A është bërë ndonjë zgjidhje deri tash, a është lidhur ndonjë kontratë me ndonjë kompani.

Bashkim Budakova, tha se do ta ngris një çështje e cila është ngritur disa herë në kuvend, bëhet fjale për hedhjen e mbeturinave në vendet e pa dëshiruara. Deshta me pyet a është ndërmarr ndonjë veprim konkret ose ndonjë kampanje senzibilizuese për vedisimin e kësaj kategorie të qytetarëve. A është paraparë ndonjë masë ndëshkuese. A është bërë vendosja e shenjave informuese për ndalimin e mbeturinave apo të ngjashme.

Rinor Murati, tha se kam dy çështje për ti adresuar e para ka te bëjë rreth mësimit tërë ditor, a ka komuna jonë kapacitet të mjaftueshme për te filluar një projekt të tillë. Dhe çështja tjetër në rrugën “Hamdi Bislimi” Kompania e Ujësjetllësit ka zhvilluar disa punime mirëpo nuk është kthyer në gjendjen e më parëshme rruga.

Egzona Bytyqi, tha se këto ditë Instituti i Shëndetit Publik ka ngrit alarm për raste të reja të fruthit në nivel të Kosovës një rast ka qenë i identifikuar edhe ne komunën tonë. Unë i bëj thirrje të gjithë prindërve nga kjo foltore që ti vaksinojnë fëmijët sipas kalendarit të rregullt të imunizimit. Pyetja e dytë për kryetarin e di që si komune keni qenë aplikues të banimit të përballueshëm e kjo e menduar që të realizohet në fshatin Magurë, dua të di edhe në këto momente që po flasim qëndron ende përgjigjja negative nga qeveria. Tjetra pyetje projekti i ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës si po ecën dinamika e punës aty dhe a po shkon gjithçka sipas planit. Çështja e fundit e ndaj mendimin me parafolësen Albionen, sa i përket shqetësimit rreth gjendjes së mbledhjes së mbeturinave.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se i kam disa çështja për ti ngritur e para ka të bëjë me destinacionin më të frekuentuar shtegun e ecjes, është koha që komuna me filluar një renovim, pasi që ka filluar demolimi atje si i tavolinave ulëseve, por duhet të bëhet edhe rrethoja që ka qenë kërkesë e me hershme për shkak që rrezikohen fëmijët. Po ashtu të bëhet edhe dezinsketimi i vazhdueshëm për shkak se ka insekte të shumta. Tjetra shkolla "Hasan Zyko Kamberi" është e vetmja shkollë që mungon mbishkrimi apo pllaka që e identifikon këtë shkollë me këtë poet të madh. Në fushën e sportit në shkollën "Vëllezërit Frashëri" janë dëmtuar shumë rrethojat koshi i basketbollit dhe shtyllat, aty ka nevojë për renovim. Po ashtu kam një kërkesë të objekti i Dinos apo lagjja përreth kishës, trotuari është demoluar aty ka nevojë të riparohet trotuari. Dhe çështja që po e ngris që disa seanca është rrugica që lidhë rrugët "Zylfie Gashi" me "Isa Olluri ". Edhe sa do të presin qytetarët të rregullohet ajo rrugicë.

Nexhmedin Lekiqi, tha se do ti ngris dy çështja e para e di që është e buxhetume projekti rreth shpellës me muri dhe zgjerim të stacionit. Kam një pyetje a pritët që ky projekt të filloj para fluksit të turistëve. Dhe tjetra rruga e dytë kryesore në Gadime që kalon në fshatin Gllavicë aty është një kthesë e pa përshtatshme pasi që aty është ajo rrugë e pa kalueshme për dy vetura edhe është mirë të buxhetohet dhe të zgjerohet.

Fadil Spahiu, tha se kam 3 kërkesa, e para ka të bëjë me asfaltimin e rrugicës që ka të bëjë familjet Krasniqi në lagjen "Xhevdet Rexhepi" që lidhet me rrugën për Kraishtë përballë burgut të rrugica e Grackes së Vjetër. Kërkesa e dytë është kërkesë e përsëritur për asfaltim të dy rrugicave në fshatin Smallsuhë tek rruga që lidhet me rrugën e shkollës të rruga "Spahiu" janë dy lagje. Dhe kërkesa e tretë është për të njoftuar kompaninë DAF e cila merret me beton, në rrugën e Smallushes ku shpesh herë e len rrugën të pa pastruar me zhavorr dhe aty po shkaktohet pluhur dhe po shkakton rrezik për qytetarët.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se do te ju përgjigjem disa pyetjeve e para muri gabion në Gadime është si projekt është në procedurë, me marrëveshje me Demosin dhe do te kryhet brenda vitit. Sa i përket rrugicave e dijmë ku ka nevojë dhe aty ku ka mundësi do të asfaltohen në shumicën e fshatrave. Shtigjet kanë nevojë për mirëmbajtje. Ka nevojë për mirëmbajtje edhe për fusha të sportit në disa fshatra dhe disa investime të tjera. Problemi me madhor i ngritur nga disa diskutues është çështja e ndërmarrjes regjionale, njësia Pastrimi në Lipjan e keni parë që ditëve të fundit ka pas vështirësi ka qenë edhe mediatike mbeturinat kanë mbet para dyerve të ekonomive familjare. Ne kemi bërë disa përpjekje disa herë edhe me përfaqësuesit tonë ne kuvendin e aksionarëve por edhe me kryetaret e komunave të regjionit, dhe vështirësitë janë te dukshme. Njësia jonë në Lipjan është mirë nuk është në humbje mund ta mbaj veten dhe të krijoj të hyra shtese, e mira është që ne me u ndare. Ne kemi publikuar tenderin për bartjen dhe dërgimin e këtyre mbeturinave në deponine regjionale. Dëshiroj që ta kemi një kompani që nëse falimenton Kompania Pastrimi me pas të gatshme. Ne jemi për ta ndarë Kompanie Pastrimi. Shtëpia e Kulturës është duke shkuar në dinamiken e paraparë. Te banimi i përballueshëm ne kemi pas një kërkesë dhe ne kemi caktuar në Magurë për shkak se në Lipjan nuk kemi tokë dhe aty kemi menduar që është me e përshtatshme si lokacion. Sepse aty gjithmonë ka pas objekte të tilla. Nuk na kanë aprovuar këtë kërkesë. Plani zhvillimor komunal jemi peng edhe në këtë proces nga ministria. Rruga Kojске - Topliqan gjithmonë ka qenë por nuk kemi gjetë mbështetje financiare pasi qe është e kushtueshme. Pat kërkesa për vendosje të policeve të shtrirë, nuk mundemi çdo vend mi vendos vetëm para shkollave, xhamive, shtëpive të pamës. Projekti i sheshit është në dinamike edhe është duke u punuar. Unë jam i kënaqur me dinamikën e punës që po zhvillohet. Kërkesa për barnatore mundë të plotësohet me adresa të sakta. Do ti asfaltoj të gjitha rrugët dhe rrugicat e premtuara.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 41-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 40-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 41-të e Kuvendit, pas votimit u konstatua se Kuvendi me, 25 vota për , aprovoi Ekstraktin e 41-të të Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit (2025-2030) dhe Planit të Veprimit Rinor Lokal (2025-2027).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica- Llugiqi drejtoreshë e DKRS-së e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se kjo strategji synon të krijoj kushte të favorshme për pjesëmarrje aktive zhvillim profesional dhe mirëqenie për te rinjtë, dhe Planit të Veprimit Rinor Lokal përkthen këtë vizion në hapa konkret përmes aktiviteteve në arsim, punësim, kulture, sport dhe përfshirje qytetare. Këto dy dokumente janë të rëndësishme sepse ofrojnë një drejtim të qartë mbi nevojat reale të të rinjve të komunës së Lipjanit. Si kryesues i komitetit për kulture rini dhe sport kame qenë edhe pjesë e kësaj strategjie dhe plani ku si komitet kemi adresuar edhe rekomandimet tona. Një nder rekomandimet ka qenë që çdo vit të kemi një raport në kuvend nga organizata impementuese. Vlen të theksohet se tani kemi 3 fishim të kostos buxhetore. Urojmë që të këtë rezultat në arritjen e objektivave.

Shahadije Dragaçina, tha se unë e kam vetëm një çështje për të ngritur e pash që për baze është marr edhe Strategjia Shtetërore për Rini 2024-2032, ku përmendet braktisja e mësimin por në strategjinë e komunës nuk e pash që përmendet si sfide apo objektive se çka duhet të bëjë komuna për fëmijët që e braktisin mësimin.

Arsim Jashari, tha se fillimisht në emër të grupit ne do ta mbështesim këtë plan sepse është i rëndësishëm për rininë. Por fillimisht unë i kam nxjerr disa konkludime të cilat do të duhej dashtë me qenë brenda kësaj strategjie dhe plani të veprimit. E para komuna me një numër të madh të rinis po përballlet me sfida të mëdha në veçanti të sektorit të teknologjisë inovacionit dhe ndërmarrësi. Unë i kam nxjerr 4 shtylla; E para krijimi i një qendre inovative rinore, krijimi i një hapësire moderne për të rinjtë që do të ofroj kurse për të rinjtë si programime, inteligjencë artificiale, monitorim ide biznesi e të tjera. Shtylla e dytë, fuqizimi përmes edukimit dhe trajnimeve profesionale, partneriteti me universitete, shkolla profesionale dhe organizata jo qeveritare, menaxhim projekte e të tjera. Shtylla e tretë, financimi dhe mbështetja për ndërmarrësi rinore, grante fillestare për start up rinore, gara për ide novative dhe platforma ndërkombëtare të financimit. Shtylla e katërt rritja e pjesëmarrjes së përfaqësimit

rinor, krijimi i një këshilli rinor aktiv ne bashkëpunim me komunën, ngritje e vetëdijes përmes fushatave sociale dhe rrjeteve motivuese. Përndryshe ne do ta mbështesim këtë plan.

Aniila Reqica-Llugiqi, tha se ju falënderoj për idetë e dhëna, ju njoftoj që pjesë e kësaj strategjia ka qenë edhe Drejtorja e Arsimit në grupin punues. Kemi menduar që fillimisht me startuar me këtë numër të objektivave nga Strategjia Shtetërore. Ju kisha lutë kur janë në debate publike të epni kontributin tuaj.

Arsim Jashari, tha se unë e kam dhënë kontributin tim si ne sport si te të gjitha aspektet këtë e dinë të gjithë. Unë atë që e thash sot, jeta është duke shkuar ka teknologjia dhe rinia me doemos do te shkoj në atë drejtim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë Muze të veteranëve të UÇK-së në Zonën Kadastrale Krojmir.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahut, drejtoreshë e DGJK, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se ne kur jemi nis për kuvend ideja ka qenë që të votojmë për këtë pikë, me qëllimin më të mirë që të ju plotësohet banoreve dhe kategorive të dala nga lufta kjo kërkesë. Mirëpo tani këto idetë e reja për te cilat ne më herët nuk kishim informata, nëse nuk kish prish punë me shtyrë si pikë me dal me u konsultuar me qytetarët dhe veteranet e luftës dhe me parë e mudnemi me gjetë një zgjidhje të përbashkët. Pasi që tani jemi në pozicion jo të lehtë dhe na kishë lehtësua nëse do te shtyhej kjo pikë.

Ganimete Qeriqi, tha se ju kisha lut edhe një herë kryesues që të shtyhet kjo pikë, ne nuk jemi kundër, por të gjendet një lokacion më i përshtatshëm, pasi që ne e kundërshtojmë si lokacion pasi që aty i kemi varrezat. Ne jemi si lagje të hapur për bashkëpunim.

Arsim Jashari, tha se unë po flas në emër të grupit dhe neve që kemi qenë pjesë e luftës po na qet në pozitë të keqe. Ne nuk jemi kundër por le të shtyhet pasi është

një mos marrëveshje për lokacionin. Derisa këta të merren vesh për lokacionin. Unë nuk votoj kundër shkronjave të arta të UÇK-së asnjëherë.

Shkelzim Olluri, tha se 5 muaj ka pas kohë për nënshkrime ,për diskutime edhe për lokacion edhe për te gjitha, mirëpo tani ka ardh fundi dhe po dalin diskutime, po për mua shtyne deri në mbledhjen e ardhshme. Kjo kërkesë ka ardhë nga veteranet për atë lokacion në Krojmir.

Lulzim Rrustemi, tha se një temë shumë sensitive dhe shumë e ndjeshme, unë ju falënderoj nëse pajtohem me shty për një mbledhje tjetër. Ne si grup i PDK-së, kemi ardh për me votuar këtë pikë, pas reagimeve të reja, na nuk jemi ndërmjetës të perqamjeve, por po presim me u marr vesh me pas bisedime të reja të ketë ulje te tensioneve te mirën vesh pastaj te vednsoest.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ky diskutim ose pikë i ka afër 6 muaj që është futur në buxhet, e para i ka 10 ditë që e kemi dërguar ftesën, pse me herët nuk pat reagime.

Ganimete Qeriqi, kjo pikë për lokacionin si pikë e kuvendit materiali na ka ardhë më vonë . Unë e falënderoj Shkelzimin që po pranon me u shtyrë në mbledhjen e radhës.

Arsim Jashari, tha nëse arrini me shtyrë këtë pikë ju falënderoj nga zemra, tjetra materiali për këtë pikë ka ardhë më vonë, po ashtu nuk e kam ditë as për problemin ndoshta u dashtë edhe Ganimetja me na njoftuar më herët që ka mosmarrëveshje. Unë pres me u shtyrë kjo pikë për mbledhjen e ardhshme dhe ku do që caktohet lokacioni unë do ta votoj.

Fadil Sopa, tha se edhe unë pajtohna që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës derisa të mirën vesh fshati mes vete për lokacionin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit dha pauze për 5 minuta për konsultim mes grupeve.

Pas pauzës prej disa minutave u kthyen.

Kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se pas kërkesës se anëtareve të kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme duke e obliguar OVL e UÇK-së, në Krojmir bashke me drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër që në afat brenda 2 jave të i sjell 3 propozime për lokacionin për ndërtimin e kësaj Shtëpie Muze në Krojmir. Lokacionin

aktual dhe dy propozime të tjera mandej bashkë si kuvend të vendosim për lokacionin që është me i pranueshëm për lokalitetin atje.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi propozimin për shtyrje të kësaj pike.

IV

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ky propozim ka ardh si rezultat i kërkesës dhe dakordances së përgjithshme. Si grup i PDK-së, ne e mbështesim këtë propozim, sepse edhe në aspektin fetar edhe atë kulturor me këtë vendim është bërë një zgjidhje afatgjate.

Meqë diskutime të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ZK-Grackë e Vjetër.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Smetishti, drejtor i DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup e mbështesim këtë Propozim Vendim, edhe pse ky vendim është dashtë me ardh më herët. Unë e kam një pyetje nëse bëhet kërkesa për evidim për ndryshimin e etazhitetit të hartave zonale dhe ende nuk fillon projekti a ka mundësi me u rrit etazhiteti. A duhet me u ndryshuar kontrata, qe prej 4 kate me u bo 8 katë ndërtim në atë pjesë. A ka bazë ligjore.

Alban Salihu, tha se edhe unë e pata te njëjtën pyetje si parafolësi. Kam edhe një pyetje tjetër e kam analizuar lënden a parashihet afat kohor për përfundimin e projektit dhe a parashihen veprime nëse nuk përfundon me kohë. Pasi që jemi dëshmitar që projekte të tilla po zgjatin shumë.

Lulzim Rrustemi, tha se si pjesë e komisionit vlerësues një punë voluminoze, 3 herë kemi shpallë thirrjen publike, nuk ka qenë interesimi i madh, por interesim solid por ne kemi zgjedh më të mirën e mundshme që ka aplikuar në njoftimin publik. Komisioni ka punuar në mënyrë të pavarur për ti bërë një zgjidhje kategorive të dala nga lufta. Unë ju uroj atyre do te jenë përfitues. Uroj që ky projekt të realizohet në tërsi.

Rinor Murati, tha se është një projekt që duhet përshëndetur, kam vetëm një vërejtje për drejtorin, ku drejtori e falënderoi vetëm komisionin vlerësues e jo edhe komisionin e ankesave që i kemi shqyrtuar ankesat që kanë te bëjnë me me këtë pronë.

Imri Semetshti, tha se i falënderoj edhe komisionin e ankesave por keni krye një detyrim të cilin e kemi marr. Sa i përket pyetjes për mundësinë e rritjes se etazhi tetit është pak e ndjeshme dhe nuk mundemi me dhëne përgjigjeje të prerë. Personalisht mendoj që nuk do ta kemi këtë mundësi, pasi që do ti qesim në pozitë jo të barabarte me pjesëmarrësit që kanë qenë në atë proces. Afati kohor i ndërtimit është 48 muaj. Me rastin e lidhjes se kontratës ofertuesi do të bëjë edhe sigurimin bankar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Kryetarëve të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Elmaze Behluli, drejtoreshë e DA e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se kjo pagesë rrjedh prej Rregullores se Punës së Kuvendit që e kemi votuar mandatin e kaluar, këtu po përfshihen 54 kryetar. Ne si kuvend duhet me pas një raport për secilin kryetar te fshatit për punën e tyre, pasi që

ka kryetar që është pasiv. Në Komitetin për Komunitete na kanë treguar që kryetari i Janjevës ka dhënë dorëheqje dhe nuk merret me fshatin dhe kjo është e pa drejtë që të paguhet dikush që nuk është aktiv.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se secili kryetar i fshatit do ta vërtetoj përmes procesverbaleve punën e bërë.

Rinor Murati, tha se është për tu përshëndetur një vendim i tillë dhe komuna jonë është në mesin e pak komunave që kanë aktive këto këshilla dhe ky propozim vendim vlen për tu mbështetur.

Lulzim Rrustemi, tha pasi që nuk po kemi mënyra dhe forma të tjera të pagesave, po i tejkalojmë. Por mos të mendojë që ne si kuvend nuk po dimë asgjë pasi që vet qytetarët po na demantojnë po tregojnë nuk është mbajt asnjë mbledhje, është mirë me i kontrolluar ata që nuk kanë funksionuar mos me marr pagesë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se një kohë nuk kemi mujt me i kompensuar ata kane punuar edhe pa kompensim, është mirë që po e kemi mundësi me i paguar në këtë mënyre.

Egzona Bytyqi, tha se unë e kam thënë mendimin timë dhe ne jemi pro vendimit të tillë siç e thanë edhe parafolësit pasi që ka me qenë nxitëse dhe kemi me lehtë dhe me lyp llogari. Mirëpo ajo që e kam thënë në KPF mos me qenë shuma uniforme me u dalluar, jo njëjtë shumen një fshat i madh sikur një i vogël.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ligji nuk na lejon një ndarje të tillë, pasi që ligjërish ata janë të barabartë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- zyra në Kosovë (IRW).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-se e mbështesim këtë propozim vendim dhe sa me shumë që vijmë grande aq ma mire për qytetarët.

Armend Grajqevci, tha se edhe ne si grup i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim dhe kjo është një hap i mirë i përkrahjes së të rinjve. Është një shumë e konsiderueshëm e mjeteve.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për furnizimin e përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative “KRM” Pastrimi në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Ardit Cani, tha se ne si grup i PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim. Në takimin që kemi pasë ne aksionaret me kryeshefin e Kompanisë Pastrimi kryeshefi është zotuar se këto mjete do ti kthehen komunës. Por është mirë që të ceket në vendim që furnizimi të bëhet vetëm për njësinë e pastrimit ne Lipjan.

Arsim Jashari, tha se unë dua ti falënderoj dhe ti respektoj e vlerësoj ata punëtorët të cilët po e bëjnë një punë e cila me se pakti po vlerësohet te ne, e që nuk është në rregull. Dhe ne e mbështesim këtë propozim vendim qysh e tha edhe parafolësi më herët.

Rinor Murati, tha se qytetarët paguajnë për shërbimet dhe ne nuk jemi përgjegjës për keq menaxhimin si në rastin në fjalë. Urojmë që të këtë një ndryshim të gjendjes.

Valon Pacolli, tha se në propozim vendim është e parapare që vetëm për njësinë operative në Lipjan. Ne kemi marr garance që këto do të jenë vetëm për Lipjan. Nuk ka keq menaxhim por ka mosmarrëveshje mes komunës dhe kompanisë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se Kompania Pastrimi do të furnizohet vetëm me naftë dhe do të caktohet dhe menaxheri i kontratës nga Kryetari i Komunës.

Alban Salihu, tha edhe në KPF u diskutua që këto mjete do të kthehen, këto do të ndahen përmes subvencioneve si do të kthehen këto mjete a ka diçka të shkruar apo vetëm fjalë.

Ardit Cani, tha se nuk ka keq menaxhim, mirëpo Prishtina është aksionari më i madh me 77% të aksioneve dhe problemin kryesor e ka shkaktuar Prishtina dhe pasojat po i bartim edhe ne.

Valon Pacolli, tha se me propozim vendim është subvencion, për kthim të mjeteve është vetëm një deklaram i kryeshefit. Kompania ka të drejtë me u furnizuar me naftë 30 ditë.

Rinor Murati, tha se ne bashkërisht nuk jemi përgjegjës për një situatë të tillë. Uroj që Lipjani të ketë ndërmarrjen e vetë publike.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, dhe 4 abstenime, aprovoi propozimin

IX

Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 1Nr.464-47684 të datës 29.09.2025 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës të tokës bujqësore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica- Llugiqi drejtoreshë e DKRS-së e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se klubi i Gadimes ka nevojë për një stadium dhe të gjithë jemi të obliguar me përkrah dhe me mbështet. Unë kam një propozim vendim pasi që është e destinuar për sport vetëm fjalinë e fundit toka bujqësorë me e larguar. Ne si grupi i PDK-se, e mbështesim.

Nexhemdin Lekiqi, tha se ne emër KF Gadimja, në emër të sportistëve dhe të gjithë qytetarëve të asaj pjese ju falënderoj nëse e mbështetni këtë projekt. Po ashtu falënderoj edhe anëtarët e KPF-se, që mbështeten. Uroj që kjo shprehi të vazhdojmë më tutje me rajonin e Gadimes Babushit me rrethinë. Uroj që të kemi sa më shumë projekte të tilla.

Shahadije Dragaçina, tha se problemi është se nga një tokë bujqësore që është dhënë në shfrytëzim sa ka baze ligjore që ti kaloj një klubi në shfrytëzim. Sa ka bazë ligjore.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha një sqarim, kontrata përfituesit i skadon ne janar 2025, mirëpo ai vet ka dërguar me shkrim që do ta liroj atë pjesë para afatit. Jemi munduar me te gjithë akteret me gjet një bazë ligjore sepse aty është një pjesë e mirë. Po presim me pas përgjigje pozitive.

Arsim Jashri, tha se mos harroni qe kuvendi ka te drejt me autorizuar Kryetarin e Komunës për një çështje te caktuar apo për një pronë. Shpresoj qe edhe ministria me gjetë mirëkuptim në këtë rast. Është mirë me u bo bashkë dhe me mbështet.

Nexhmedin Lekiqi, tha se herën e parë ka dështuar për arsye se lokacioni ka qenë i përcaktuar si tokë minerare. Mirëpo toka bujqësore mundet me u destinuar për diçka tjetër dhe ne këtë rast te shndërrohet ne zonë rekreative për sport.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi propozimin

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se për fund ua uroj festen e Kurban Bajramit të gjithëve, po ashtu ju njoftoj që me datën 12 qershor do te këtë një mbledhje solemne.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12:45

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi